



Funded by the  
European Union

**Autoriteti Kontraktor: Bashkia Përmet**

**Projekti "Key People-Key Knowledge"**  
Kontrata e grantit IPA/2022/434-967

Udhëzime për aplikantët e sub-granteve

Referenca: **IPA/2022/434-967/GRANTS/1**

Afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve:  
**19.07.2024 në 14:00**

## SHËNIM

Kjo thirrje për sub-grante është në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian "Key People-Key Knowledge, i cili zbatohet nga Bashkia e Përmetit dhe Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare. Thirrja synon rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, krijimin dhe promovimin e veprimtarisë së ligjshme ekonomike, sigurimin e mbështetjes direkte dhe ngritjen e kapaciteteve të individëve për të parandaluar dhe luftuar fenomenin e kultivimit dhe përdorimit të kanabisit. Kjo guidë jep informacion në lidhje me thirrjen e sub-grantit, duke përfshirë kriteret e pranueshmërisë, procesin e dorëzimit të aplikimit, procesin e vlerësimit si dhe informacion të përgjithshëm rreth projektit.

Aplikantët duhet të kenë lexuar këto udhëzime përpara se të aplikojnë, për të siguruar respektimin e rregullave dhe kriterëve për sub grantet.

## Tabela e përmbajtjes

<b>1. SUB-GRANTE NË KUADËR TË PROJEKTIT TË FINANCUAR NGA BE "KEY PEOPLE-KEY KNOWLEDGE.....</b>	<b>4</b>
1.1. Hyrje .....	4
1.2. Objektivat e thirrjes dhe çështjet prioritare .....	4
1.3. Ndarja financiare e siguruar nga autoriteti kontraktues.....	5
<b>2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROPOZIME</b>	<b>5</b>
2.1. Kriteret e pranueshmërisë.....	5
2.1.1. Veprimet e pranueshme: veprimet për të cilat mund të bëhet aplikimi.....	5
2.1.2. Përshtatshmëria e kostove: kostot që mund të përfshihen.....	7
2.1.3. Klauzolat e etikës dhe Kodi i Sjelljes .....	8
<b>2.2. Si të aplikoni dhe procedurat për të ndjekur .....</b>	<b>9</b>
2.2.1. Formularët e aplikimit .....	9
2.2.2. Ku dhe si të dërgoni aplikacione .....	9
2.2.3. Afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve.....	10
2.2.4. Informacione të mëtejshme rreth aplikimeve .....	10
<b>2.3. Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve .....</b>	<b>10</b>
<b>2.4. Njoftimi i vendimit të Autoritetit Kontraktor .....</b>	<b>11</b>
2.4.1. Përmbajtja e vendimit.....	11
2.4.2 Afatet .....	11
<b>3. LISTA E SHTOJCAVE</b>	<b>12</b>

# 1. SUB GRANTE NË KUADËR TË PROJEKTIT TË FINANCUAR NGA BE "KEY PEOPLE-KEY KNOWLEDGE"

## 1.1. HYRJE

Projekti i financuar nga BE "Key People, Key Knowledge", me kontratë granti IPA/2022/434-967, është pjesë e mbështetjes së dhënë në kuadër të Programit BE për Zhvillimin Socio-Ekonomik për Shqipërinë (si alternativë kundër kultivimit dhe trafikimit të drogës), thirrja e dytë. Projekti filloi më 10 tetor 2022 dhe ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh, deri në Tetor 2025. Objektivi i përgjithshëm i projektit është krijimi i mundësive të reja të punës/biznesit për gratë dhe të rinjtë e papunë, reduktimi i pabarazisë duke mbështetur lidhshërinë e grave në biznes dhe iniciativave të vetëpunësimit dhe të japë një përgjigje të përshtatur ndaj rreziqeve të marginalizimit ekonomik, politik dhe kulturor të territorit të synuar. Për më tepër, projekti synon të përforcojë dhe lehtësojë zhvillimin e një kulture të shoqërisë civile dhe të ndihmojë në rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe njohurive të ndërsjellta midis shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale në zonën e Përmetit. Projekti synon të arrijë dy rezultate:

- Krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës të mjeteve mbështetëse për të konsoliduar sipërmarrjen në nivel lokal.
- Përmirësimi i marrëdhënieve sociale dhe dialogut në zonat rurale nëpërmjet nxitjes së turizmit, aktiviteteve kulturore dhe sportive.

Për të arritur rezultatin e parë:

- Të paktën 50 persona (gra, të rinj, etj) u mbështetën nga ekspertët nëpërmjet trajnimeve dhe mentorimit për krijimin dhe menaxhimin e një organizate jo fitimprurëse dhe një biznesi .
- U krijua një inkubator biznesi me të gjitha pajisjet e nevojshme dhe po përdoret nga përfituesit e projektit dhe persona të tjera , të rinj, start-up-et etj.
- Do të hapet një thirrje publike për mbështetjen e ideve të reja të start-up.

Për të arritur rezultatin e dytë:

- Salla e ping pongut në Përmet është rikonstruktuar dhe ajo përdoret çdo ditë nga fëmijët dhe të rinjtë.
- Në shkollën e Petranit është krijuar një sallë ping-pong për tu ofruar mundësinë për t'u trajnuar njerëzve në zonën rurale.
- Një zyrë informimi rekreacionale/ turistike është krijuar brenda ndërtesës së Njësisë Administrative Petran, dhe zyra është funksionale.
- Një fagon i cili shërben si bibliotekë e lëvizshme është blerë dhe udhëton në zonat rurale për të angazhuar nxënës të rinj, mësues dhe prindër në promovimin e librit.

## 1.2. OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE ÇËSHTJET PRIORITARE

**Objektivi i përgjithshëm** i kësaj thirrjeje lidhet me objektivin e përgjithshëm të projektit, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, krijimin dhe promovimin e veprimtarisë së ligjshme ekonomike, sigurimin e mbështetjes direkte dhe ngritjen e kapaciteteve të individëve për të parandaluar dhe luftuar fenomenin e kultivimit dhe përdorimit të kanabisit.

Objektivat **specifike** të kësaj thirrjeje janë:

- T'u jepet mundësia përfituesve të vënë në jetë idenë e tyre të biznesit.
- Të përmirësojnë gjendjen e tyre ekonomike duke filluar biznesin e tyre.
- Rritja e shkallës së punësimit, duke marrë parasysh se start-up-et e reja do të punësojnë persona të tjerë.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve dhe prodhimit të mallrave dhe shërbimeve në zonën e Përmetit.
- Frymëzimi i komunitetit.

Kjo thirrje për sub grante do të kontribuojë në arritjen e rezultatit të parë të pritshëm të projektit " Krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës të mjeteve mbështetëse për të konsoliduar sipërmarrjen në nivel lokal ".

**Rezultati** që do të arrihet përmes kësaj thirrjeje është: Të paktën pesë nisma start-up të mbështetura financiarisht për të filluar biznesin e tyre të ri ose për të përmirësuar biznesin e tyre ekzistues duke krijuar më shumë mundësi ekonomike për njerëzit e tjerë dhe duke nxitur aktivitetin e ligjshëm ekonomik.

**Prioritetet** e kësaj thirrjeje janë:

- Për të mbështetur idetë e reja start-up në Bashkinë e Përmetit, që do të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të grupeve vulnerabël.
- Të mbështesë biznesin e vogël që operon në Përmet për të përmirësuar biznesin e tyre ekzistues duke krijuar më shumë mundësi ekonomike për njerëzit e tjerë.

Veprimi i propozuar duhet të trajtojë një nga përparësitë e përmendura më sipër.

Kjo Thirrje për propozime synon dy grupe:

**Target Grupi 1:** Të rinjtë, gratë, personat vulnerabël (personat në rrezik për t'u angazhuar në kultivimin e kanabisit) që duan të nisnin një biznes të ri në Përmet.

**Target Group 2:** Bizneset e vogla ekzistuese që duan të përmirësojnë biznesin e tyre duke krijuar më shumë mundësi ekonomike për njerëzit e tjerë.

### 1.3. NDARJA FINANCIARE E SIGURUAR NGA AUTORITETI KONTRAKTOR

Shuma e totale e vënë në dispozicion në këtë thirrjeje për propozime është **40.000 EUR** (dyzet mijë). Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha fondet në dispozicion.

*Madhësia e granteve*

Çdo grant i kërkuar sipas kësaj thirrjeje për propozime duhet të jetë midis shumës minimale dhe maksimale të mëposhtme:

- **Shuma minimale: 4,000 EUR (katër mijë)**
- **Shuma maksimale: 8,000 EUR (tetë mijë)**

Çdo veprim i mbështetur në kuadër të kësaj thirrjeje për sub grante duhet të ketë një **komponent të investimit kapital** (punë dhe furnizime për t'u prokuruar) i cili duhet jetë midis përqindjeve minimale dhe maksimale të mëposhtme:

- Përqindja minimale: 30% e totalit të kostove të pranueshme të sub grantit.
- Përqindja maksimale: 60% e totalit të kostove të pranueshme të sub grantit.

Të paktën, 2% e e kostove të pranueshme të sub grantit duhet të përdoren për aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit.

## 2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROPOZIME

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për paraqitjen, përzgjedhjen dhe zbatimin e veprimeve të financuara sipas kësaj thirrjeje, në përputhje me udhëzuesin praktik, i cili është i zbatueshëm për këtë thirrje (të disponueshme në internet në këtë adresë <https://wikis.ec.europa.eu/display/ExactExternalWiki/ePRAG> ).

### 2.1. KRITERET E PRANUESHMËRISË

Për të qenë i pranueshëm për këtë thirrje aplikuesi duhet:

-Të jetë shtetas shqiptar mbi 18 vjeç, rezident në Bashkinë e Përmetit, i cili ka një ide për të hapur një biznes që ndikon në zhvillimin lokal të zonës .

ose

-Të jetë person fizik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në pesë vitet e fundit, që ushtron aktivitetin në Përmet.

dhe

- të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në aplikim.

Aplikantët e mundshëm nuk mund të marrin pjesë në këtë thirrje ose t'u jepet një grant nëse ndodhen në ndonjë nga situatat e listuara në seksionin 2.6.10.1 të udhëzuesit praktik.<sup>1</sup>

#### **2.1.1. Veprimet e pranueshme: veprimet për të cilat mund të bëhet aplikimi**

Kohëzgjatja: Kohëzgjatja fillestare e planifikuar e një veprimi duhet të mos jetë më pak se 3 muaj dhe më shumë se 6 muaj.

Vendndodhja: Veprimet duhet të zhvillohen në Bashkinë e Përmetit.

Llojet e veprimeve të cilat mund të financohen sipas kësaj thirrjeje:

<sup>1</sup> <https://wikis.ec.europa.eu/display/ExactExternalWiki/2.+Basic+rules#id-2.Basicrules-2.6.10.1.Exclusioncriteria>

- Fillimi i një aktiviteti të ri ekonomik.
- Përmirësimi i produkteve/shërbimeve/procese në bizneset e vogla ekzistuese.
- Ndërhyrjet që aplikojnë qasje dhe teknologji inovatore, të integruara dhe të “zgjuara” për mbështetjen e start-up-eve dhe përmirësimin e produkteve/shërbimeve/procese në bizneset e vogla ekzistuese.
- Ndërhyrjet që nxisin mbrojtjen e mjedisit, fuqizimin e të rinjve dhe grave dhe veprimtarinë e ligjshme ekonomike, veçanërisht në zonën rurale.
- Veprimet në sektorët ekonomikë të mëposhtëm:
  1. Agroturizmi
  2. Agroindustria
  3. Bujqësia
  4. Industria krijuese/artizanati
  5. Turizmi i qëndrueshëm dhe mikpritja
  6. Bimët aromatike medicinale
  7. Marketing digjital
  8. Mbrojtja e mjedisit

Lista është treguese dhe jo shteruese.

Llojet e mëposhtme të veprimeve nuk janë të pranueshme:

- veprime që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me sponsorizimet individuale për pjesëmarrje në workshope, seminare, konferenca dhe kongrese.
- veprime që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me bursa individuale për studime ose kurse trajnimi.
- Studimet përgatitore ose përgatitja e projektimit paraprak për punimet që do të kryhen në kuadër të projektit.
- Veprime të lidhura me partitë politike.
- Veprime të cilat janë në kuadër të veprimtarive të përgjithshme të institucioneve kompetente shtetërore apo shërbimeve të administratës shtetërore, përfshirë pushtetin vendor.
- Veprime të kufizuara në donacione bamirësie.
- Veprimet e mbuluara dhe të financuara nga programe të tjera të BE.

Aktivitetet treguese të mëposhtme mund të financohen në kuadër të kësaj thirrje:

- Aktivitete në mbështetje të nismave të fuqizimit ekonomik të ndërmarrja nga gratë dhe të rinjtë, veçanërisht në zonat rurale.
- Aktivitete që sjellin zgjidhje inovatore dhe kreative dhe teknologji të “zgjuara” për mbështetjen e start-up-eve dhe përmirësimin e produkteve/shërbimeve/procese në bizneset e vogla ekzistuese.
- Aktivitete që mbështesin promovimin e bizneseve të vogla në Përmet.
- Prokurimi i punimeve, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për fillimin e një aktiviteti ekonomik në sektorët ekonomikë të përmendur më sipër.
- Prokurimi i punimeve, pajisjeve dhe materialeve të nevojshëm për përmirësimin e produkteve/shërbimeve/procese në bizneset e vogla ekzistuese në sektorët ekonomikë të përmendur më sipër.
- Aktivitete që do të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të grupeve vulnerabël.

**Lista e përmendur më sipër e llojeve të aktiviteteve nuk është shteruese, ato janë vetëm treguese. Aktivitete të tjera të përshtatshme ose inovative që nuk përmenden më sipër mund të konsiderohen për financim kur ato kontribuojnë qartë në arritjen e objektivave të thirrjes.**

#### Mbështetje financiare për palët e treta

Aplikantët nuk mund të propozojnë mbështetje financiare për palët e treta.

#### Vizibiliteti

Aplikantët duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të bërë publik faktin se Bashkimi Evropian e ka financuar ose bashkëfinancuar veprimin. Nëse Komisioni Evropian nuk pranon ndryshe,

veprimet që financohen plotësisht ose pjesërisht nga Bashkimi Evropian duhet të sigurojnë shikueshmërinë e financimit të BE-së duke shfaqur emblemën e BE-së në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në udhëzimet për përfituesit e financimit të BE-së, të publikuara nga Komisioni Evropian. Nëse është e zbatueshme, aktivitetet e komunikimit mund të ndërmerren për të rritur ndërgjegjësimin e audiencës specifike ose të përgjithshme për arsyet e veprimit dhe mbështetjes së BE-së për veprimin në vendin apo rajonin e interesuar, si dhe rezultatet dhe ndikimin e kësaj mbështetjeje.

Të gjitha masat dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me vizibilitetin dhe, nëse është e zbatueshme, komunikimin, duhet të përputhen me kërkesat më të fundit të komunikimit dhe shikueshmërisë për veprimin e jashtëm të financuar nga BE, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni Evropian ([Kërkesat e Komunikimit dhe Shikueshmërisë për Veprimet e Jashtme të BE-së | Partneritetet Ndërkombëtare \(europa.eu\)](#)).

Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikantët

Aplikuesi nuk mund të paraqesë më shumë se një aplikim për këtë thirrjeje.

Aplikantit nuk mund ti jepet më shumë se një grant në këtë thirrjeje.

### **2.1.2. Përshatshmëria e kostove: kostot që mund të përfshihen**

Vetëm 'kostot e pranueshme' mund të mbulohen nga një grant. Kategoritë e kostove që janë të pranueshme dhe jo të pranueshme janë listuar më poshtë. Buxheti është një vlerësim i kostove si dhe një tavan i përgjithshëm për 'kostot e pranueshme'.

Kostot direkte të pranueshme

Kostot e mëposhtme janë të pranueshme:

- Kostoja e personelit të caktuar për veprimin, që korrespondon me pagat reale bruto duke përfshirë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe kosto të tjera lidhur me pagën (duke përfshirë shpërblimet).
- Kostot e materialeve (consumables) të dedikuara posaçërisht për veprimin.
- Kostot e mirëmbajtjes së llogarisë bankare (jo kostot e transferimit)
- Qiraja e hapësirës për të ushtruar aktivitetin e biznesit.
- Kostot që lidhen me funksionimin e biznesit (taksat vendore & tarifa, kosto regjistrimi, tel/internet, energji elektrike/ngrohje, mirëmbajtje etj)
- Furnizime dhe shërbime për veprimtaritë që mbështesin zbatimin e veprimit.
- Kostot për komunikimin dhe vizibilitetin e veprimit.
- Kostot e blerjes të pajisjeve dhe materialeve të dedikuara posaçërisht për qëllimet e veprimit dhe funksionimin e biznesit.
- Blerja e pajisjeve teknike dhe pajisjeve dhe programeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).
- Ndërhyrje të vogla në infrastrukturë për përmirësimin e ambjenteve që do të përdoren për qëllime biznesi.

Rezerva e emergjencës

Nuk zbatohet për këtë thirrjeje.

Kostot indirekte të pranueshme

Nuk zbatohet për këtë thirrjeje.

Kontributet në natyrë

Nuk zbatohet për këtë thirrjeje.

Kosto të papranueshme

Kostot e mëposhtme nuk janë të pranueshme:

- Borxhet dhe tarifet e shërbimit të borxhit (interesat).
- Provizionet për humbjet ose detyrimet e mundshme në të ardhmen.
- Kostot e deklaruara nga përfituesi dhe të financuara nga një tjetër veprim apo program që merr një grant të Bashkimit Evropian (përfshirë nëpërmjet EDF).
- Kostot e pagave të personelit të administratës publike.
- Blerje tokash ose ndërtesash.
- Humbjet nga këmbimit valutor.
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH);

- Kontribute në natyrë (përveç punës së vullnetarëve).
- Detyrimet doganore dhe të importit apo çdo tarifë tjetër.
- Gjobat, gjobat financiare dhe shpenzimet gjyqësore.
- Kostot e konsulencës për përgatitjen e aplikimit.
- Kostot e kryera para fillimit të zbatimit të veprimit; Pagesat prapavepruese nuk lejohen.
- Kredi për palë të treta.
- Shpërblimet e përfshira në kostot e stafit.

### **2.1.3. Klauzolat e etikës dhe Kodi i Sjelljes**

#### a) Mungesa e konfliktit të interesit

Aplikuesi nuk duhet të preket nga ndonjë konflikt interesi dhe nuk duhet të ketë asnjë lidhje ekuivalente në këtë aspekt me aplikantët e tjerë apo palët e përfshira në veprime. Çdo përpjekje e një aplikanti për të marrë informacion konfidencial, për të hyrë në marrëveshje të paligjshme me konkurrentët ose për të ndikuar komisionin e vlerësimit ose autoritetin kontraktor gjatë procesit të shqyrtimit, sqarimit, vlerësimit dhe krahasimit të aplikimeve do të çojë në refuzimin e aplikimit të tij dhe mund të rezultojë në ndëshkime administrative sipas Rregullores Financiare në fuqi.

#### b) Respektimi i të drejtave të njeriut si dhe legjislacioni mjedisor dhe standardet thelbësore të punës

Aplikanti dhe stafi i tij duhet të respektojnë të drejtat e njeriut. Në veçanti, dhe në përputhje me aktin e zbatueshëm, aplikantët që u janë dhënë kontrata duhet të respektojnë legjislacionin mjedisor duke përfshirë marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore, dhe standardet bazë të punës siç janë të zbatueshme dhe siç përcaktohet në konventat përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (si konventat për lirinë e shoqërimit dhe pazareve kolektive; eliminimin e punës së detyruar dhe të detyrueshme; shfuqizimin e punës së fëmijëve).

#### c) Kundër korrupsionit dhe ryshfetit

Aplikuesi duhet të respektojë të gjitha ligjet, rregullat dhe kodet e zbatueshme lidhur me korrupsionin dhe ryshfetin. Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të pezullojë ose anullojë financimin e projektit nëse praktikat korruptive të çfarëdo lloji zbulohen në çdo fazë të procesit të dhënies së grantit ose gjatë zbatimit të një kontrate dhe nëse autoriteti kontraktor nuk merr të gjitha masat e duhura për të ndrequr situatën. Për qëllimet e kësaj dispozite, 'praktikat korruptive' janë ofrimi i ryshfetit, dhuratës, pagesës ose komisionit për çdo person si nxitje ose shpërblim për kryerjen ose frenimin nga çdo akt që ka të bëjë me dhënien e një kontrate ose zbatimin e një kontrate të lidhur me autoritetin kontraktor.

#### d) Shpenzime të pazakonta tregtare

Aplikimet do të refuzohen ose kontratat do të ndërpriten nëse del se dhënia ose zbatimi i një kontrate ka shkaktuar shpenzime të pazakonta tregtare. Shpenzime të tilla të pazakonta tregtare janë komisione që nuk përmenden në kontratën kryesore ose që nuk rrjedhin nga një kontratë e përfunduar siç duhet duke iu referuar kontratës kryesore, komisione që nuk paguhen në këmbim të ndonjë shërbimi faktik dhe të ligjshëm, komisione të hequra në një parajsë fiskale, komisione të paguara për një pagues që nuk është identifikuar qartë ose komisione të paguara për një kompani e cila ka çdo pamje të të qenit një kompani guackë.

Përfituesit e granteve të cilët zbulohen se kanë paguar shpenzime të pazakonta tregtare për projektet e financuara nga Bashkimi Evropian janë përgjegjës, në varësi të seriozitetit të fakteve të vërejtura, që kontratat e tyre të përfundojnë ose të përjashtohen përgjithmonë nga marrja e fondeve të BE/EDF.

#### e) Shkelja e detyrimeve, parregullsive apo mashtrimeve

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të pezullojë ose anullojë procedurën, kur procedura e dhënies së grantit provohet se ka qenë subjekt i shkeljes së detyrimeve, parregullsive apo mashtrimeve. Nëse shkelja e detyrimeve, parregullsitë ose mashtrimet zbulohen pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të përfundojë kontratën.



## 2.2. SI TË APLIKONI DHE PROCEDURAT PËR TË NDJEKUR

### 2.2.1. Formularët e aplikimit

Aplikimet duhet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet në këtë guidë. Aplikantët duhet t'i përmbahen rreptësisht formatit të formularit të aplikimit dhe të plotësojnë paragrafët dhe faqet sipas renditjes.

Plotësoni formularët e aplikimit me kujdes dhe sa më qartë të jetë e mundur në mënyrë që aplikimi të mund të vlerësohet siç duhet.

Çdo gabim apo mospërputhje madhore lidhur me pikat e renditura në udhëzim ose ndonjë mospërputhje madhore në aplikim (p.sh. nëse shumat në buxhet janë gabim) mund të çojë në refuzimin e aplikimit.

Sqarimet do të kërkohen vetëm kur informacioni i dhënë është i paqartë dhe kështu pengon autoritetin kontraktor të kryejë një vlerësim objektiv.

Ju lutem vini re se vetëm formulari i aplikimit dhe anekset e publikuara të plotësuara, do të vlerësohen. Prandaj është e rëndësishme që këto dokumente të përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me aplikimin.

#### Formularët e aplikimit që duhet të dorëzohen janë:

1. Formulari i aplikimit të projektit (Shtojca A) në gjuhën shqipe.
2. Buxheti i projektit (Shtojca B) në gjuhën shqipe.
3. Deklarata e aplikuesit (Shtojca C) në gjuhën shqipe.
4. Formulari i entit ligjor i plotësuar dhe nënshkruar detyrimisht nga aplikanti shoqëruar me dokumentet justifikuese të kërkuara aty (kopje e kartës së identitetit ose ekstraktit historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me datë pas datës së hapjes së thirrjes/ Aneksi D) në gjuhën angleze.
5. Një formular identifikimi financiar i aplikantit, në rastin kur është një biznes i regjistruar. Individët do ta dërgojnë atë pas regjistrimit të bizneseve dhe hapjes së një llogarie bankare për biznesin e ri. Kjo bankë duhet të jetë në vendin ku është themeluar aplikanti (Shtojca E) në gjuhën angleze.
6. Deklaratë e nderit (Shtojca H) në gjuhën angleze.

Nuk duhet të dërgohen anekse të tjera.

### 2.2.2. Ku dhe si të dërgoni aplikimet

Aplikimet duhet të dorëzohen një origjinal dhe një kopje në madhësinë A4. Paketa e plotë e aplikimit duhet të jetë në format elektronik (CD-ROM ose USB në një file të veçantë dhe të vetëm (pra aplikimi nuk duhet të ndahet në disa file të ndryshëm). Dosja elektronike duhet të përmbajë **saktësisht të njëjtin** aplikim me atë fizik. Aplikimet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Zarfi i jashtëm duhet të mbajë **numrin e referencës së thirrjes**, së bashku me emrin dhe adresën e plotë të aplikantit, dhe fjalët <Not to be opened before the official opening session> dhe '<Të mos hapet para hapjes zyrtare>'.  
'.

Aplikimet duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur me postë, shërbim korrier privat ose dorazi (një vërtetim i nënshkruar dhe me datën e dorëzimit do t'i jepet dërguesit) në adresën më poshtë:

Adresa postare

MUNICIPALITY OF PERMET/ BASHKIA PERMET  
Sheshi "Abdyl Frasheri", Nr.1, 6401,Përmet, Shqipëri

Adresa për dorëzimin dorazi

MUNICIPALITY OF PERMET/ BASHKIA PERMET  
Sheshi "Abdyl Frasheri", Nr.1, 6401,Përmet, Shqipëri  
Orari i hapjes për tenderuesit: 08:00-16:00

Aplikimet e dërguara me çdo mjet tjetër (p.sh. me faks ose me e-mail) ose të dorëzuara në adresë të tjera do të refuzohen.

Ju lutem vini re se aplikimet jo të plota mund të refuzohen. Aplikantët këshillohen të verifikojnë që aplikimi i tyre është e plotë.

### **2.2.3. Afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve**

Vëmë në dijeni aplikantët për faktin se ekzistojnë dy sisteme të ndryshme për dërgimin e aplikimeve: njëri është me postë ose me shërbim privat korrier, tjetri dorazi.

Në rastin e parë, aplikimi duhet të dërgohet përpara datës së fundit të aplikimit, siç evidentohet nga vula e dorëzimit në zyrën postare, dhe në rastin e dytë është vërtetimi i marrjes në dorëzim i dhënë në momentin e dorëzimit të aplikimit, i cili do të shërbejë si provë.

Afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve është data 19.07.2024 siç vërtetohet nga data e dërgimit, vula e dorëzimit në zyrën postare ose vërtetimi i marrjes në dorëzim. Në rastin e dorëzimeve dorazi, afati i i fundit është në datën 19.07.2024 para orës 14:00 me orën lokale, siç dëshmohet nga vërtetimi i nënshkruar dhe me datë. Çdo kërkesë e paraqitur pas afatit do të refuzohet automatikisht.

Autoriteti kontraktor mundet, për arsye të efektshmërisë administrative, të refuzojë çdo kërkesë të paraqitur në kohë në shërbimin postar, por të marrë, për çfarëdo arsye përtej kontrollit të autoritetit kontraktor, pas datës së hyrjes në fuqi të hapit të parë të vlerësimit, nëse pranimi i kërkesave që janë paraqitur në kohë, por që kanë mbërritur me vonesë, do të vononte në mënyrë të konsiderueshme procedurën e dhënies së granteve ose do të rrezikonte vendimet e marra dhe njoftuara tashmë. (shih kalendarin tregues nën seksionin 2.4.2).

Çdo kërkesë e paraqitur pas afatit përfundimtar do të refuzohet.

### **2.2.4. Informacione të mëtejshme rreth aplikimeve**

Një sesion informues mbi këtë thirrje do të organizohet më datë 02.07.2024 ora 10:00 në Sallën e Konferencave në katin e dytë të Qendrës Multifunkcionale Kulturore "Odhise Paskali", Përmet.

Pyetjet mund të dërgohen me e-mail jo më vonë se 21 ditë përpara afatit të fundit paraqitjes së aplikimeve në adresën e mëposhtme, duke treguar qartë referencën e thirrjes për propozime:

E-mail adresa: [info@bashkiapermet.gov.al](mailto:info@bashkiapermet.gov.al)

Autoriteti kontraktues nuk ka detyrim të japë sqarime për pyetjet e marra pas kësaj date.

Përgjigjet do të jepen jo më vonë se 11 ditë para afatit të fundit të paraqitjes së aplikimeve.

Për të siguruar trajtim të barabartë të aplikantëve, autoriteti kontraktor nuk mund të japë një opinion paraprak mbi pranueshmërinë e aplikantëve, një veprim apo aktivitete specifike.

Pyetjet që mund të jenë relevante për aplikantët e tjerë, së bashku me përgjigjet, do të publikohen në faqen e internetit ku është publikuar thirrja: faqja e internetit e Bashkisë së Përmetit: [www.bashkiapermet.gov.al](http://www.bashkiapermet.gov.al), dhe faqen e projektit: <https://keypeoplekeyknowledge.com/>. Prandaj është e këshillueshme të konsultoheni rregullisht me faqet e internetit të sipërcituara në mënyrë që të informoheni për pyetjet dhe përgjigjet e publikuara.

Ju lutem vini re se autoriteti kontraktor mund të vendosë të anullojë procedurën e thirrjes për sub grantenë çdo fazë sipas kushteve të përcaktuara në seksionin 6.5.9 të PRAG.

## **2.3. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE**

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga autoriteti kontraktor me ndihmën e mundshme të vlerësuesve të jashtëm. Të gjitha aplikimet do të vlerësohen sipas hapave dhe kritereve të mëposhtme. Nëse gjatët shqyrtimit të aplikimit vihet re se veprimi i propozuar nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në seksionin 2.1, kërkesa do të refuzohet mbi këtë bazë të vetme.

### **(1) HAPI 1: HAPJA DHE KONTROLLET ADMINISTRATIVE**

Gjatë hapjes dhe kontrollit administrativ do të vlerësohen:

- Nëse afati është përmbushur. Përndryshe, kërkesa do të refuzohet automatikisht.
- Nëse janë dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara. Nëse ndonjë nga informacionet e kërkuara mungon ose është i pasaktë, aplikimi mund të refuzohet mbi këtë bazë të **vetme** dhe aplikimi nuk do të vlerësohet më tej.

Aplikantët do të njoftohen zyrtarisht për rezultatet e hapit të parë.

### **(2) HAPI 2: VLERËSIMI I APLIKIMIT**

Nëse aplikimet kalojnë hapin e parë, ato do të vlerësohen më tej mbi cilësinë e tyre, duke përfshirë buxhetin e propozuar. Ato do të vlerësohen duke përdorur kriteret e vlerësimit më poshtë.

Seksioni	Pikët maksimale
<b>1. Relevanca e idesë së biznesit</b>	<b>10</b>
1.1 Relevanca me objektivat dhe prioritet e thirrjes dhe temave/sectorëve/fushave specifike ose çdo kërkesë tjetër specifike e deklaruar në udhëzimet për aplikantët	5
1.2 Elemente të veçanta me vlerë të shtuar (p.sh. qasje inovatore, inovacion, praktika më të mira, barazi gjinore, Çështjet mjedisore/të ndryshimeve klimaterike, Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik lokal, fuqizimi i rinisë dhe grave, përfshirja sociale)	5
<b>2.KRITERET operative</b>	<b>50</b>
2.1 Propozimi i vlerës (Realizueshmëria e nismës dhe mundësia e tregut).	<b>10</b>
2.2 Karakteristikat e produkteve dhe shërbimeve dhe përfitimet që sjellin	<b>5</b>
2.3 Grupi i synuar i klientëve .	<b>10</b>
2.4 Analiza e konkurrencës.	<b>5</b>
2.4 Kapaciteti i burimeve njerëzore.	<b>5</b>
2.6 Rritja potenciale dhe kontributi në mundësitë e punësimit.	<b>10</b>
2.7 Plani i aktiviteteve (a janë aktivitetet të qarta dhe të realizueshme?)	<b>5</b>
<b>3. Kriteret financiare/ buxheti</b>	<b>20</b>
<b>Rezultati total maksimal</b>	<b>80</b>

Aplikantët do të njoftohen zyrtarisht për rezultatet e hapit të dytë.

### **(3) HAPI 3: PREZANTIMI I IDESË SË BIZNESIT**

Aplikantët që do të marrin një vlerësim të paktën 50 pikë në hapin e dytë do të njoftohen zyrtarisht për datën e prezantimit së idesë së tyre të biznesit përpara komisionit të vlerësimit. Pikët maksimale për prezantimin e idesë do të jenë 20 pikë.

#### *Përzgjedhja e përkohshme*

Pas vlerësimit, do të hartohet një tabelë me aplikimet e renditura sipas pikëve të tyre. Aplikimet me vlerësimin më të lartë do të zgjidhen përkohësisht deri në arritjen e fondit në dispozicion për këtë thirrje për sub grante. Përveç kësaj, një listë rezervë do të hartohet duke ndjekur të njëjtat kritere. Kjo listë do të përdoret nëse më shumë fonde bëhen të disponueshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së listës rezervë.

### **(4) HAPI 4: VERIFIKIMI I PRANUESHMËRISË SË APLIKANTËVE**

Verifikimi i pranueshmërisë do të kryhet në bazë të dokumenteve mbështetëse të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Ajo do të kryhet vetëm për aplikimet që janë përzgjedhur përkohësisht sipas vlerësimeve të tyre dhe brenda buxhetit në dispozicion për këtë thirrje për propozime. *Aplikantët që do të hapin biznese të reja duhet të regjistrojnë biznesin e tyre brenda 15 ditëve pas njoftimit të rezultatit. Kontrata e grantit do të nënshkruhet pas regjistrimit të biznesit.*

Çdo kërkesë e refuzuar do të zëvendësohet nga aplikimi tjetër më i mirë i vendosur në listën rezervë që bie brenda buxhetit në dispozicion për këtë thirrje për propozime.

## **2.4. NJOFTIMI I VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTOR**

### **2.4.1. Përmbajtja e vendimit**

Aplikantët do të njoftohen me shkrim për vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me aplikimin e tyre dhe, nëse refuzohen, arsyet e vendimit negativ.

Një aplikues që beson se ka një gabim ose parregullsi gjatë procesit të dhënies të sub grantit mund të paraqesë një ankesë. Shih seksionin 2.12 të udhëzuesit praktik.

Aplikantët dhe, nëse janë entitete juridike, persona që kanë kompetenca përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi to, informohen se, nëse janë në një nga situatat e zbulimit ose përjashtimit të hershëm, detajet e tyre personale (emri, emri i dhënë nëse personi natyror, adresa, forma ligjore dhe emri dhe emri i dhënë i personave me kompetenca përfaqësimi, Vendimmarrja ose kontrolli, nëse personi juridik) mund të regjistrohet në sistemin e zbulimit dhe përjashtimit të hershëm, dhe t'u komunikohet

personave dhe njërive të interesuara në lidhje me dhënien ose ekzekutimin e një kontrate granti. Për më shumë informacion, ju mund të konsultoheni me deklaratën e privatësisë që disponohet në [http://ec.europa.eu/budget/explained/management/protecting/protect\\_en.cfm](http://ec.europa.eu/budget/explained/management/protecting/protect_en.cfm)

## 2.4.2. Afatet

	DATA	KOHA
1. Takim informuese	02.07.2024	10:00
2. Afati i fundit për të kërkuar ndonjë sqarim nga autoriteti kontraktor	29.06.2024	
3. Data e fundit në të cilën do tu përgjigjet kërkesave për sqarim autoriteti kontraktor	09.07.2024	-
4. Afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve	19.07.2024	14:00
5. Informacion për aplikantët mbi hapjen dhe kontrollin administrativ (Hapi 1)	26.07.2024	-
7. Informacion për aplikantët mbi vlerësimin e aplikimeve dhe njoftimin për datën e prezantimit të idesë së biznesit (Hapi 2)	31.07.2024	-
8. Njoftimi i vendimit (pas kontrollit të pranueshmërisë) (Hapi 3+4)	09.08.2024	-
9. Nënshkrimi i kontratës	01.09.2024	-

Të gjitha orët janë në zonën kohore të vendit të autoritetit kontraktor

Kjo tabelë i referohet datave të pritshme (me përjashtim të datave 2, 3 dhe 4) dhe mund të përditësohet nga autoriteti kontraktor gjatë procedurës. Në raste të tilla, orari i përditësuar do të publikohet në faqen e internetit ku është publikuar thirrja: website i Bashkisë Përmet [www.bashkiapermet.gov.al](http://www.bashkiapermet.gov.al) dhe webiste i projektit: <https://keypeoplekeyknowledge.com/>.

## 3. LISTA E SHTOJCAVE

### DOKUMENTET QË DO TË PLOTËSOHEN

1. Formulari i aplikimit të projektit (Shtojca A) në gjuhën shqipe.
2. Buxheti i projektit (Shtojca B) në gjuhën shqipe.
3. Deklarata e aplikuesit (Shtojca C) në gjuhën shqipe.
4. Formulari i entit ligjor i plotësuar dhe nënshkruar detyrimisht nga aplikanti shoqëruar me dokumentet justifikuese të kërkuara aty (kopje e kartës së identitetit ose ekstraktit historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me datë pas datës së hapjes së thirrjes/ Aneksi D) në gjuhën angleze.
5. Një formular identifikimi financiar i aplikantit, në rastin kur është një biznes i regjistruar. Individët do ta dërgojnë atë pas regjistrimit të bizneseve dhe hapjes së një llogarie bankare për biznesin e ri. Kjo bankë duhet të jetë në vendin ku është themeluar aplikanti (Shtojca E) në gjuhën angleze.
6. Deklaratë e nderit (Shtojca H) në gjuhën angleze.

\*\*\*